Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Shkelzen Hoxha	**07.07.2023**	**17.07.2023**	**2023/0469**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.07.2023, OE "**WOOD CORPORATION L.L.C**."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0469, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ku është rekomanduar për kontratë OE "**Mobelland**" SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Inventarizimi i administrates komunale**" me nr. të prokurimit: 616-23-2147-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur çmimi më i lirë, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura:

Ligji i Prokurimit Publik

• Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

• Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

• Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Rregullorja 001/2022 e Prokurimit Publik

• Neni 37 - Mostrat e tenderëve.

Pretendimet Ankimore

HYRJE

1. Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës (Tutje referuar si: "Autoriteti Kontraktues") me datën 16.03.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë për Aktivitetin e Prokurimit me titull "Inventarizimi i administratës komunale" dhe me numër të prokurimit 616-23-2147-1-2-1. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave ishte data 10.04.2023.

2. Operatori ekonomik Wood Corporation LLC (Tutje referuar si: "Ankuesi"), brenda afatit i ka dorëzuar ofertën e plotë Autoritetit Kontraktues, duke plotësuar të gjitha kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik dhe Dosjes së Tenderit.

3. Me datën 12.04.2023 është bërë hapja e tenderëve dhe leximi i çmimeve dhe nga procesverbali i hapjes së tenderëve vërehet se nga 13 oferta të pranuara nga Autoriteti Kontraktues, oferta e Ankuesit ishte ajo me çmimin më të lirë.

4. Gjatë fazës së vlerësimit, përkatësisht me datën 24.05.2023 ora 15:20 Ankuesi ka pranuar kërkesë nga ana e Autoritetit Kontraktues për sqarimin e tenderit, ku me këtë kërkesë i kërkoheshim brenda pesë ditësh, t'i sillte fizikisht për vlerësim mostrat e produkteve për pozicionet sipas katalogut:

i. Pozicioni nr.3 - Tavolinë pune me pjesën anësore

ii. Pozicioni nr.18 - Karrika lëvizëse

iii. Pozicioni nr . 24 - Rafti për libra

5. Edhe pse kjo kërkesë nuk ishte në përputhje me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregullave të Prokurimit Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, operatori Wood Corporation e ka pranuar këtë kërkesë, por ka kërkuar që koha në dispozicion për prodhimin e këtyre produkteve të cilat nuk i ka në stok por që do ti prodhonte nga fillimi, të jetë më e arsyeshme, përkatësisht afati për dorëzimin e mostrave t'i zgjatet të paktën për 10 ditë kalendarike sa do t'i duheshin që produktet të prodhohen, ngjyrosen dhe të jenë të gatshme për prezantim.

6. Autoriteti Kontraktues i përgjigjet se nuk mund të zgjas afatin pasi nuk lejojnë afatet ligjore (pa cekur cilat janë ato afate apo bazuar në cilin nen të Ligjit referoheshin) por komisioni ofron që të vizitoj fabrikën dhe të i shikoj produktet në vend punishte dhe jep si alternativë datën 29 dhe 30 të muajit Maj.

7. Ankuesi përgjigjet menjëherë dhe i fton komisionin për vizitë në fabrikë me datën 30 maj ora 11:00. Komisioni nuk shfaqet në fabrikë në orën e paracaktuar dhe dakorduar në mes të palëve. Pas kërkesës për sqarim se pse të njëjtit nuk kanë ardhur, Komisioni përgjigjet se për shkaqe objektive nuk kanë mundur të vijnë në vizitë dhe e obligojnë operatorin ekonomik Wood Corporation që mostrat t'i sjellë më së largu deri me datën 31.05.2023 në objektin e

Autoritetit Kontraktues.

8. Operatori i dërgon mostrat 1 dhe 2, ndërsa kërkon mirëkuptim që mostra nr. 3 për shkak të volumit të madh që ka Rafti të vizitohet në vend punishte dhe Autoriteti Kontraktues pajtohet. Por sërish me datën 01.06.2023 nuk shfaqet në vend punishte. Për më tepër me datën 02.06.2023 i dërgon edhe një letër operatorit me të cilën e obligon që edhe mostrën 3 ta sjell në objektin e Komunës për vlerësim, më së largu deri në orën 14:00 të po asaj dite.

9. Përkundër afateve tejet të shkurtra dhe qasjes jo bashkëpunuese të komisionit vlerësues, Ankuesi i sjell të gjitha mostrat në objektin e Komunës për vlerësim dhe plotëson kërkesat edhe pse këto kërkesa nuk ishin në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik, me qëllim që të mos lejoj hapësirë për eliminim.

10. Me datën 13.06.2023 Autoriteti Kontraktues publikoi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (Tutje referuar si: "Vendimi i Kontestuar") me të cilin u pa se oferta e Ankuesit është eliminuar, jo për ndonjë shkak tjetër, por për shkak të vërejtjeve në mostra, të cilat ishte detyruar që ti sjell në mënyrë të kundërligjshme dhe në afate shumë të shkurtra edhe pse i është bërë me dije Autoritetit se mostrat nuk janë në stok dhe të njëjtat duhet të prodhohen sipas katalogut dhe dosjes së tenderit.

11. Për shkak të shkeljeve ligjore në vlerësimin e ofertës së Ankuesit menjëherë kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim, duke i bërë me dije Autoritetit Kontraktues se oferta është eliminuar pa të drejtë dhe në kundërshtim me dispozitat për vlerësimin e tenderëve dhe kërkimin e mostrave. Kërkesa për rishqyrtim është refuzuar nga ana e Zyrtarit përgjegjës të prokurimit duke e lënë kështu në fuqi Vendimin e Kontestuar. Duke mos pasur alternativë tjetër Ankuesi përmes kësaj Ankese i drejtohet Organit Shqyrtues të Prokurimit për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave subjektive nga vendimi i paligjshëm i autoritetit kontraktues.

II. BAZA LIGJORE PËR APROVIMIN E ANKESËS

12. Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë në konsideratë Nenin 37 [Mostrat e tenderëve] të Rregullores 001/2022 e Prokurimit Publik në të cilën thuhet: "Dokumentet e tenderit në përgjithësi duhet të shmangin kërkesën për paraqitjen e mostrave, pasi kjo kërkesë dekurajon konkurrencën dhe rrit çmimet e ofertës. Përndryshe, tenderuesve duhet tu kërkohet të konfirmojnë që produkti i tyre plotëson specifikimet e kërkuara dhe në mbështetje të bashkëngjitni çertifkatat e duhura të testimit nga laboratorë të njohur testimi. Kur kërkohen mostrat ato mund të dorëzohen paraprakisht, ose gjatë kohës së mbylljes së tenderit. Ato duhet të dorëzohen para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve." Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me këtë rregull pasi që mostrat i ka kërkuar pas afatit të dorëzimit të tenderëve dhe ka imponuar afate të shkurtra të dorëzimit të cilat diskriminojnë kompanitë prodhuese siç është Wood Corporation.

13. Me aplikimin e afateve të shkurtra operatori ankues Wood Corporation LLC është vënë në pozitë të pabarabartë pasi që i njëjti këto produkte është dashur t'i prodhoj brenda një afati të pamjaftueshëm e që ka ndikuar që produkti të mos jetë plotësisht sipas katalogut të ofruar, por kjo duket qartë se nga Autoriteti Kontraktues është bërë me qëllim të eliminimit të operatorit Wood Corporation LLC nga ky aktivitet i prokurimit.

14. Kërkesa për mostrat të produkteve është keqpërdorur nga ana e Autoritetit Kontraktues, pasi që Ankuesin si prodhues e vendos në pozitë të pabarabartë në raport me kompanitë të cilat

bëjnë importe të produkteve. Pasi që afati për dorëzimin e mostrave i është caktuar shumë i shkurtër dhe i pamjaftueshëm objektivisht për të bërë prodhimin e mostrave në përputhje me kriteret e përcaktuara.

Andaj meqë Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë të kërkoj këto mostra pas dorëzimit të tenderëve, me respekt kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të nxjerr këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik WOOD CORPORATION LLC me adresë në Zonën Industriale, Shiroke rruga Uke Bytyqi, p.n, Suharekë.

II. ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës i datës 12.06.2023 dhe lënda i kthehet për Rishqyrtim.

III. DETYROHET Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës që të shmangë kërkesën për mostra të produkteve pas dorëzimit të tenderëve dhe vlerësimin e ofertave ta vazhdoj me katalogjet e kërkuara.

KRITERET PËR VLERËSIM

Autoriteti Kontraktues në dokumentin të cilin e të bashkangjitur në sitëm si aneks të veçantë e që është pjesë e Dosjes së tenderit ka potencuar se AK: Sipas nevojës Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit ka të drejtë të kërkoj që të sillen mostra të inventarit.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Sipas raportit të vlerësimit të nënshkruar nga ZPP dhe anëtarët e komisionit me datën: 13.06.2023 (data kur është nënshkruar nga ZPP) kanë analizuar dhe vlerësuar mostrat se OE ankues të cilat i ka dorëzuar por nuk janë sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **WOOD CORPORATION L.L.C.**

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues komuna e Prishtinës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë t? hapur - kontratë publike kornizë - furnizim, vlerë e mesme, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët me poentim/peshim vlera e parashikuar e kontratës: 100,00.00 euro.

Pretendimi kryesor ankimor ka të bëjë kundër propozimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimit ankimore, eksperti shqyrtues sqaron pretendimin ankimor.

Autoriteti Kontraktues AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe dosjen e tenderit në platformën elektronike me datën: 15.03.2023 dhe në DT – Specifikimi teknik (dokument shtese ngritur ne platformën elektronike/KATALOGUNE INVENTARIT), ku është kërkuar dhe specifikuar qartë po citoj: ***"Sipas nevojës Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit ka të drejtë të kërkoj që të sillen mostra të inventarit"*** **.**

Dhe gjatë fazës/afateve kohore të përcaktuara me **Rregullore Nr. 001 /2022 Për Prokurimin Publik** dhe duke u bazuar **në Neni 24, Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve** konstatoj se as një operator ekonomik OE si dhe as OE ankues, nuk ka kërkuar informata sqaruese lidhur me Mostrat e Inventarit të përcaktuar në DT/katalog, d.m.th janë pajtuar me këto kushte dhe vetëm pas eliminimit lidhur me MOSTARTA, te cilat edhe vete e pranon ne ankesën e tij, se nuk janë konform katalogut, specifikimit teknik te dosjes se tenderit, si dokument themelore për përgatitjen e tenderëve nga operatoret ekonomik.

Me datën 24.05.2023 AK ka kërkuar nga OE përmes letrës standarde për sqarimin e tenderit që ti sjell mostrat për vlerësim fizikisht sipas DT/katalogut lidhur me cilësinë dhe përputhshmërinë me specifikat e kërkuara sipas DT/FDT për tri (3) pozicione:

i. Pozicioni nr.3 - Tavolinë pune me pjesën anësore

ii. Pozicioni nr.18 - Karrika lëvizëse

iii. Pozicioni nr . 24 - Rafti për libra

Operatori Ekonomik ankues brenda afatit të përcaktuar nga AK ka dorëzuar mostrat ashtu siç e potencon edhe vet në ankesën e bërë në OSHP me datën: 06.7.2023, duke e parë raportin e vlerësimit të AK –së OE i ka dorëzuar mostrat në fjalë, por nuk i ka dorëzuar konform specifikimit teknik katalogut dhe dosjes së tenderit ashtu siç e potencon edhe vet OE në ankese bërë, se mostrat nuk janë ne pajtim te plote me Dosjen Tenderit – Specifikimi teknik (dokument shtese ngritur ne platformën elektronike/KATALOGUN E INVENTARIT), duke ofruar mostra ne kundërshtim me specifikimin teknik te dosjes se tenderit.

Autoriteti Kontraktues në FDT ka paraqitur qartë dhe ka bërë të ditur se sipas nevojës autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit ka të drejtë të kërkoj që të sillen mostra të inventarit. Kërkesa për mostra për operatorët ekonomik për vlerësim nga komisioni i vlerësimit është bërë konform dosjes së tenderit DT dhe katalogut, nenit 69 të LPP –së, ku thotë; "Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale paragrafi 1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen, dhe paragrafi 2.4 po i këtij neni mostrave të produktit, si dhe konform nenit 45.18 të Rregullore Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik, për të vlerësuar cilësinë dhe përputhshmërinë me specifikat e kërkuara sipas DT/FDT.

Prandaj, eksperti shqyrtues, sqaron se duke marr baze kriteret e përzgjedhjes si dhe specifikimin teknik te dosjes se tenderit, AK – komisioni i vlerësimit – ZPP ne këtë aktivitet te prokurimit ka respektuar nenin 7, 59, 60 dhe 69 të LPP-së.

Duke e parë të gjithë materialin, dokumentet dhe pretendimit e OE ankues dhe analizës dhe sqarimet e lartë përmendura, për mendimin e ekspertit pretendimet e OE ankues janë të pa bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **WOOD CORPORATION L.L.C.**

Shkelzen Hoxha